



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.  
DREJTORIA E PROKURIMIT DHE ANKANDIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më \_\_\_/ 08/2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje MNZ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 35111000-5-pajisje zjarrfikëse

VLERA E FONDIT LIMIT: : 4,551,600 (katër milion e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se se 40 % vlera e fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP dhe ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

#### **Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen të paraqiten:**

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

#### **OSE**

Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë përpara afatit të fundit për hapjen e ofertave nga një mostër përfaqësuese një copë për artikujt me numër rendor 1, 3, 4, 10, 13, 17 sipas tabelës së sasive.

Mostrat të paraqiten dhe të dorëzohen në zyrën e protokoll arkives të Albpetrol sha Patos me seli në rrugën Fier-Patos km 7, së bashku me një dokument për paraqitje mostre të protokolluar në Albpetrol sha, përpara afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, në mënyrë që të jenë në dispozicion të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

\*Mostrat do të jenë kofidenciale për secilin Operator Ekonomik dhe do të kthehen Operatorit ekonomik brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës me paraqitjen e një kërkesë pranë AK nga ana e OE ofertues.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6 germa a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter ndihmon AK në vlerësimin sa më të drejtë nga ana teknike të mallit të ofruar dhe shërben gjithashtu për të vërtetuar nëse malli i ofruar është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe plotëson kërkesat e AK.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqese katalog/skede teknike nga prodhuesi, per artikujt me numër rendor 1, 3, 4, 10, 13, 17 sipas tabelës së sasive.

Katalogu/Skeda teknike te permbaje karakteristikat teknike te artikujve që janë objekt i prokurimit me qellim që Autoriteti Kontraktor të gjykoje nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në katalogun/skedën teknike të paraqitur të shenjohen në mënyrë të dukshme të gjitha specifikimet teknike të mallit të ofruar. (Pjesët specifike të katalogut/skedës teknike ku jepen karakteristikat e mallit që ofertohet nqs nuk janë në gjuhën shqipe të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se malli i ofruar eshte ne përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikaten ISO 9001:2015 mbi ”Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme eshte përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të kësaj kërkesë AK kërkon të sigurohet që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin dhe janë të certifikuar në përputhje me kërkesat e menaxhimit cilësisë, dhe ky kriter i vendosur është në përputhje të plotë me objektin e prokurimit.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes pranë Autoritetit Kontraktor të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit. *Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

### Njësia e Prokurimit: